

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR**  
**“Qepa e Drishtit”**  
**DATE 09.06.2021**

Sot, në datën 09.06.2021, u hartua statuti i shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor “Qepa e Drishtit” me vullnetin e plotë dhe të lirë të anëtarëve të saj. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin.

**KAPITULLI I**  
**EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë**

- 1.1 Shoqëria emërtohet si Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Qepa e Drishtit”.
- 1.2 Shoqëria themelohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në formën e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit të saj.
- 1.3 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi, kryesisht Ligjit nr. 38/2012 Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor dhe dispozitave përkatëse në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 – Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: **“Fshati Drisht, Njesia Administrative Mes, K.P. 4012, Shkodër, Shqipëri”**
- 2.2. Veprimtaria e Shoqërisë do të shtrihet në Bashkinë Shkodër dhe kudo tjetër ku ndodhet anëtarësia e saj.

**Neni 3 – Objekti**

3.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë:

- A. *Kultivimi, prodhimi dhe tregtimi i qepës së Drishtit.*
- B. *Bashkëpunimit si grup fermerësh me shoqatat e shoqërisë civile dhe projektet mbështetëse të skemave kombëtare e ndërkombëtare. Ofrimi i shërbimeve në kultivim e qepës së Drishtit për përmirësimin e saj dhe krijimin e kushteve optimale për prodhim.*
- C. *Kritje e prodhimit të produkteve e nënprodukteve të tjera të qepës së Drishtit në kushte sa më cilësore dhe kapjen e tregut me etiketën e zonës autoktone.*
- D. *Zhvillimi i agroturizmit me produktet bio të prodhuara në këtë zonë.*



E. Rritja e nivelit ekonomik të fermerëve që punojnë me qepën e Drishtit.

#### Neni 4 - Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 4.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## KAPITULLI II

### KAPITALI, KONTRIBUTET,

### NDRYSHIMI DHE TRANSFERIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

#### Neni 5 – Kapitali i Shoqërisë dhe Kontributet

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000 ALL (njëqind mijë lekë), i ndarë në 8 pjesë të zotëruara nga anëtarët themelues në masën:

<b>Rrustem Curri</b>	12,5%	12 500 lekë	1 pjesë/kuotë
<b>Musa Bahçja</b>	12,5%	12 500 lekë	1 pjesë/kuotë
<b>Selahudin Dushaj</b>	12,5%	12 500 lekë	1 pjesë/kuotë
<b>Maliq Curri</b>	12,5%	12 500 lekë	1 pjesë/kuotë
<b>Hamdi Curri</b>	12,5%	12 500 lekë	1 pjesë/kuotë
<b>Sadri Buhaj</b>	12,5%	12 500 lekë	1 pjesë/kuotë
<b>Sabri Shkambi</b>	12,5%	12 500 lekë	1 pjesë/kuotë
<b>Artan Bahçja</b>	12,5%	12 500 Lekë	1 pjesë/kuotë

- 5.2 Kontributet në natyrë shprehen në vlerë ekonomike mbi bazë të një raporti vlerësimi të bërë nga një ekspert.
- 5.3 Anëtarët janë zotërues të pjesëve sipas vlerës së kontributit të tyre në kapital.

#### Neni 6 - Transferimi dhe ndryshimi i kapitalit

- 6.1 Pjesët e kapitalit mund të fitohen/transferohen përmes:
  - a. nënshkrimit të kontributit në kapitalin e Shoqërisë
  - b. dhurimit
  - c. trashëgimisë
  - d. formave të tjera të parashikuar nga legjislacioni në fuqi
- 6.2 Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj me të gjithë pasurinë aktuale apo të ardhshme.
- 6.3 Anëtarët e Shoqërisë janë përgjegjës për detyrimet e Shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tyre të nënshkruar në kapitalin e Shoqërisë.

- 6.4 Ndryshimi i kapitalit nuk mund të jetë në asnjë rast më i vogël se kapitali minimal.

### KAPITULLI III ANËTARËT E SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR PRANIMI, LARGIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

#### **Neni 7 – Pranimi dhe largimi i anëtarëve të ShBB-së**

- 7.1 Anëtarë të Shoqërisë janë personat fizikë/juridikë të cilët përmbushin nevojat dhe interesat e tyre, lidhur me veprimtarinë bujqësore dhe/ose blegtorale që ushtrojnë. Shoqëria ka një numër minimal prej 7 anëtarësh. Ne datën e krijimit Shoqëria ka 8 anëtarë.
- 7.2 Pranimi i anëtarëve të rinj bëhet me miratimin nga Asambleja e Përgjithshme të kërkesës shkresore për pranim që i drejtohet Administratorit të Shoqërisë.
- 7.3 Pranimi i anëtarit të ri shoqërohet me nënshkrimin dhe derdhjen e kontributit të detyrueshëm në kapitalin e Shoqërisë.
- 7.4 Në rast se anëtari i miratuar nga Asambleja nuk paguan kontributin në kapital brenda 30 ditësh kalendarike nga data e miratimit, atëherë miratimi humbet vlerën juridike dhe kërkuesi duhet të aplikojë nga e para.
- 7.5 Gjatë periudhës 30 ditore, Anëtari i ri dhe pse i miratuar nga Asambleja nëse nuk ka derdhur kontributin nuk ka të drejtë pjesëmarrje dhe/ose vendimmarrje në Shoqëri. Këto të drejta i fiton në momentin e përmbushjes së detyrimit të me nënshkrimin dhe derdhjen e kontributit në kapitalin e Shoqërisë.

#### **Neni 8 – Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të ShBB-së**

- 8.1 Anëtarët kanë të drejtën të propozojnë dhe miratojnë ndryshimin e administratorit/ëve të Shoqërisë.
- 8.2 Anëtarët kanë të drejtën të propozojnë dhe miratojnë përmirësime/ndryshime të Statutit të Shoqërisë.
- 8.3 Anëtarët kanë të drejtën të propozojnë dhe miratojnë ndryshime të organikës dhe rregullave të funksionimit të brendshëm të Shoqërisë
- 8.4 Anëtarët e Shoqërisë kanë të drejtën e informimit mbi aktivitetin e Shoqërisë, llogaritë vjetore financiare, raportet e ekspertëve kontabël, mënyrat dhe procedurat e ndarjes së fitimit, etj.
- 8.5 Anëtarët e Shoqërisë kanë të drejtën e aksesimit të çdo dokumentacioni që prek interesat e tyre.




- 8.6 Anëtarët kanë të drejtë të largohen në çdo kohë nga Shoqëria sipas procedurave të specifikuar në këtë statut dhe në legjislacionin në fuqi.
- 8.7 Anëtarët kanë detyrimin të paguajnë kontributin përkatës në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.8 Anëtarët kanë detyrimin të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe në veprimtaritë që përbëjnë objektin e Shoqërisë, përveç rasteve përjashtimore të përcaktuara në nenin 15 të ligjit 38/2012 si dhe në veprimtaritë e formimit dhe kualifikimit.
- 8.9 Anëtarët kanë detyrimin të përmbushin të gjithë detyrimet e tjera që burojnë nga ky Statut dhe legjislacioni në fuqi.

### **Neni 9 – Rimbursimi i anëtarëve të larguar apo përjashtuar**


- 9.1 Anëtarët që kanë dhënë dorëheqjen ose janë përjashtuar nga Shoqëria kanë të drejtë të rimbursohen për pjesën e tyre të kapitalit, me përjashtim të rastit kur kanë detyrime të pashlyera kundrejt Shoqërisë apo kur i kanë shkaktuar kësaj të fundit një dëm financiar të konfirmuar.
- 9.2 Rimbursimi do të bëhet pa prekur pjesën e kapitalit minimal prej 100,000 lekësh të përcaktuar në ligj.
- 9.3 Rimbursimi i Anëtarit bëhet jo më vonë se 5 vjet nga data e largimit/përjashtimit të tij nga Shoqëria.
- 9.4 Në rast të kalimit të afatit 5 vjeçar, anëtari i larguar/përjashtuar ka të drejtë të kërkojë rimbursimin në rrugë gjyqësore.

### **Neni 10 - Dokumentacioni dhe kontabiliteti**

- 10.1 Shoqëria mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike në përputhje me ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar.
- 10.2 Administratori përgatit raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore, në përputhje me legjislacionin kontabël, të cilat i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme për miratim.
- 10.3 Mbajtja e regjistrave të Shoqërisë është përgjegjësi e Administratorit. Mënyrat dhe afatet e ruajtjes së tyre përcaktohen në rregulloret e brendshme të Shoqërisë.



Handwritten signature and date: "2021"



Handwritten signatures and initials: "di", "Aure", "Mura", "P"

- 10.4 Ekspert Kontabël i Shoqërisë caktohet për një periudhë një vjeçare shoqëria "Public Accounting Service Union and Trust" SHPK, me NIPT L21423032S dhe Nr. licence 231 datë 08/11/2011.


**KAPITULLI IV**  
**ORGANET E SHOQËRISË**  
**ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE ADMINISTRATORËT**

Organet e Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe Administratori.

**Neni 11- Asambleja e Përgjithshme**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme është organ vendimmarrës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e Shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme zgjedh me shumicë të thjeshtë kryetarin dhe sekretarin, për një kohëzgjatje 3 vjeçare me të drejtë riemërimi.
- 11.3 Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
- a. vendos drejtimin e politikave ekonomike të Shoqërisë;
  - b. analizon raportin e gjendjes financiare, përfshirë llogarite vjetore, shpërndarjen e fitimeve, ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financiar dhe çështje të tjera të veprimtarisë ekonomike, që konsiderohen të rëndësishme;
  - c. emëron dhe shkarkon administratorin/ët, ekspertin/ët kontabël dhe likuiduesin/it, si dhe përcakton masën e shpërblimit të tyre;
  - ç. miraton zvogëlimin apo zmadhimin e kapitalit;
  - d. miraton ndryshime ne statut;
  - dh. vendos për shpërndarjen apo mënyrën e përdorimit të fitimit të Shoqërisë, sipas dispozitave të ligjit dhe Statutit;
  - e. vendos shkrirjen, ndarjen, transformimin apo shpërbërjen e Shoqërisë;
  - ë. vendos për ndryshimet e strukturës ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të Shoqërisë;
  - f. vendos për pjesëmarrjen në forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik edhe me anë të pjesëmarrjes në kapital, aderimin në organizata me karakter përfaqësues dhe shkëputjen prej tyre;
  - g. miraton pasqyrat financiare, raportet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Shoqërisë, raportet e ekspertëve kontabël dhe të likuiduesve;
  - gj. miraton pranimin e anëtarëve të rinj, pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë si dhe largimin/përrjashtimin e tyre;
  - h. kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.
- 11.4 Për çështjet që shqyrton, Asambleja e Përgjithshme merr vendimet përkatëse, të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Shoqërisë.

5 / 8



- 11.5 Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, çdo pjesë në kapital është e barabartë me një votë.
- 11.6 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, mënyra e votimit, përfaqësimit dhe kuorumi do të kryhen në përputhje me përcaktimet e nenit 21 e vijues të ligjit nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor".

## Neni 12 - Administratori

- 12.1 Administrator i parë i Shoqërisë është zgjedhur:  
Z. **Maliq Curri**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 06-09-1962, lindur në Drisht, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal **G20906102S**  
i cili do të përfaqësojë Shoqërinë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 12.2 Kompetencat kryesore të administratorit janë:
- a. kryerja e të gjitha veprimeve të administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në zbatim të politikave të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
  - b. përfaqësimi i Shoqërisë dhe autorizimi i personave të tretë për të kryer veprime financiare me llogaritë bankare të Shoqërisë;
  - c. kujdesi për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentacionit, regjistrave dhe librave kontabël të Shoqërisë;
  - ç. përgatitja dhe nënshkrimi i bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë dhe paraqitja për miratim Asamblesë së Përgjithshme së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
  - d. krijimi i një sistemi informimi dhe vlerësimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
  - dh. kryerja e regjistrimit dhe dërgimi i të dhënave të detyrueshme të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor";
  - e. raportimi në Asamblenë e Përgjithshme për zbatimin e orientimeve dhe realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për Shoqërinë;
- 12.3 Në rast përfundimi të mandatit, administratori kryen vetëm ato detyra, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e Shoqërisë, deri në emërimin e administratorit të ri.
- 12.4 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 26 të Ligjit nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor" dhe në çdo rast në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit Shoqërisë.
- 12.5 Në rast administrimi nga më shumë se një administrator do të ndiqen parashikimet e nenit 26 të Ligjit nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor" për

përcaktimin e mënyrës së bashkëadministrimit.

## KAPITULLI V

### SHKRIRJA, NDARJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË SË BASHËPUNIMIT BUJQËSOR


#### Neni 13 – Prishja e ShBB-së

13.1 Shoqëria shkrihet dhe hyn në proces likuidimi për shkaqet e mëposhtme :

- a. përfundimi i afatit të Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit;
- b. vullneti i anëtarëve, i manifestuar nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme;
- c. përmbushja e plotë e objektit të Shoqërisë ose pamundësia për ta përmbushur atë;
- ç. zvogëlimi i numrit të anëtarëve nën minimumin ligjor të nevojshëm, për të krijuar një Shoqëri sipas dispozitave të ligjit, nëse numri i nevojshëm i anëtarëve nuk rivendoset brenda një periudhe prej 6 muajsh;
- d. bllokimi i veprimtarisë vendimmarrëse të ndonjërit prej organeve të Shoqërisë ose mosushtimi i veprimtarisë së Shoqërisë për një periudhë të vazhdueshme 5 vjeçare;
- dh. reduktimi i kapitalit të Shoqërisë nën minimumin e përcaktuar në ligj, nëse nuk rivendoset brenda një periudhe 6 mujore;
- e. nisja e procedurave të falimentimit;
- ë. mosushtimi i veprimtarisë për një periudhë të vazhdueshme 5 vjeçare dhe mos njoftimi i pezullimit të veprimtarisë;
- f. nëse Shoqëria rezulton me humbje për një periudhe të vazhdueshme 5 vjeçare;
- g. me vendim Gjykatë;
- gj. për çdo arsye tjetër, të përcaktuar në ligj.

#### Neni 14 - Likuidimi

- 14.1 Përveç rasteve kur kundrejt Shoqërisë është hapur një procedurë falimenti, verifikimi i një prej shkaqeve të përmendura në nenin 13 të këtij Statuti, ka si pasojë hapjen e fazës së likuidimit të Shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese.
- 14.2 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Në mungesë të një vendimi të Asamblesë për emërimin e likuidueseve, brenda 30 ditëve pas vendimit të prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet Gjykatës për të caktuar një likuidues.
- 14.3 Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i kërkojë Gjykatës zëvendësimin e likuiduesit nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i Shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si mësipërm.
- 14.4 Likuiduesi emërohet nga Gjykata në rastet kur Shoqëria priset me vendim Gjykatë.



7/8

14.5 Procedurat e likuidimit do të kryhen në çdo rast në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 38/2012 dhe legjislacionit në fuqi.

## KAPITULLI VI

### DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 15 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

15.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtyre dispozitave të këtij Statuti, midis anëtarëve ose midis një ose më shumë anëtarëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen me marrëveshje mes palëve. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje me marrëveshje, palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente.

#### Neni 16 – Dispozitat ligjore në fuqi

16.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.

16.2 Autorizohet Administratori i Shoqërisë, apo çdo person i autorizuar prej tij që të regjistrojë Shoqërinë në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

\*\*\*\*\*

### Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Qepa e Drishtit”

#### ANËTARËT THEMELUES:

RRUSTEM CURRI

*Rrustem Curri*  
*2021*

MUSA BAHÇJA

*Musa Bahçja*

SELAHUDIN DUSHAJ

*Selahudin Dushaj*

MALIQ CURRI

*Maliq Curri*

HAMDI CURRI

*Hamdi Curri*

SADRI BUHAJ

*Sadri Buhaj*

SABRI SHKAMBI

*Sabri Shkambi*

ARTAN BAHÇJA

*Artan Bahçja*